
**FORMATIVE ASSESSMENT AS A KEY FACTOR IN STUDENT MOTIVATION FOR
NATURAL SCIENCES IN PRIMARY EDUCATION: A COMPARATIVE STUDY
BASED ON TEACHERS' EXPERIENCE**

Albana Haziri

Primary School "Ahmet Hajdari", Kosovo, albanamuji1@gmail.com

Leonora Jegeni

University "Cyril and Method", North Macedonia, leonora.jegeni@hotmail.com

Abstract: According to the renowned educational psychologist Herbert J. Walberg, "Assessment is the most powerful corrective in teaching and learning." This research examines the essential role of formative assessment as a catalyst for enhancing student motivation within the field of natural sciences in primary education. The study focuses on the complex interaction between assessment practices and students' emotional and cognitive engagement during the learning process. The primary objective of this study is to analyze the effect produced by the consistent implementation of formative assessment on student motivation levels, as well as to identify whether significant differences exist in assessment styles among teachers with varying professional experience. Beyond the pedagogical impact, the research provides a detailed analysis of how professional experience and teaching longevity influence the frequency, type, and effectiveness of feedback provided to students.

The study aims to identify methodological discrepancies between different generations of teachers in their approach toward continuous assessment. The applied methodology follows a quantitative approach, utilizing a descriptive-analytical and correlational design that allows for the identification of cause-and-effect relationships through numerical data. The research was conducted using simple random sampling across 18 primary schools in the regions of Gjilan, Vitia, and Kamenica (9 urban and 9 rural), involving a representative sample of 500 students and 100 teachers. The sample was stratified to ensure equal representation of demographic variables. The independent variable of the study is formative assessment, while the dependent variable is student motivation, considering work experience as a moderating variable. For primary data collection, three standardized instruments were employed: the questionnaire by (Tuan, H.-L., Chin, C.-C., & Shieh, S.-H., 2005) for science motivation, consisting of 22 items on a 5-point Likert scale with high internal consistency (Cronbach's Alpha .976); and the scale by (Nicol, D. J., & Macfarlane-Dick, D., 2006) consisting of 10 items for feedback practices. Data collection procedures adhered to the ethical principles of anonymity, confidentiality, and informed consent. Data processing was performed using the SPSS statistical package (version 26.0), applying Pearson correlation tests to measure the strength of the relationship between variables, as well as One-Way Analysis of Variance (ANOVA) with post-hoc tests (Tukey, 1949) to test differences based on experience categories. The results demonstrate that the regular use of formative tools significantly increases scientific interest, self-efficacy, and self-regulation among students. This paper offers practical recommendations for the necessity of continuous professional training, based on the findings of (Palm, T., & Andersson, C., 2017) and (Näsström, G., Gardelli, T., Lindberg, O. J., & Pettersson, F., 2021) regarding the transformation of assessment culture in primary schools.

Keywords: formative assessment, natural sciences, student motivation, work experience, primary education.

**VLERËSIMI FORMATIV SI FAKTOR KYÇ NË MOTIVIMIN E NXËNËSVE PËR
SHKENCAT NATYRORE NË ARSIMIN FILLOR: NJË STUDIM KRAHASUES
BAZUAR NË PËRVOJËN E MËSIMDHËNËSVE**

Albana Haziri

SHFMU "Ahmet Hajdari", Kosovë, albanamuji1@gmail.com

Leonora Jegeni

Universiteti "Kirili dhe Metodi", Maqedoni e Veriut, leonora.jegeni@hotmail.com

Abstrakt: Sipas psikologut të njohur të edukimit Herbert J. Walberg, "Vlerësimi është korrigjuesi më i fuqishëm i mësimdhënies dhe mësimnxënies." Ky hulumtim shqyrton rolin thelbësor të vlerësimit formativ si një katalizator për rritjen e motivimit të nxënësve brenda fushës së shkencave natyrore në arsimin fillor. Në fokus të studimit është ndërveprimi kompleks midis praktikave të vlerësimit dhe angazhimit emocional e kognitiv të nxënësve gjatë procesit të të nxënësve. Qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë efektin që prodhon zbatimi i rregullt i

vlerësimet formativ në nivelin e motivimit të nxënësve, si dhe të identifikojë nëse ekzistojnë dallime domethënëse në stilin e vlerësimit mes mësuesve me përvojë të ndryshme pune. Përtej ndikimit pedagogjik, hulumtimi analizon në mënyrë të detajuar se si përvoja profesionale dhe jetëgjatësia në punën e mësimit ndikojnë në shpeshësinë, llojin dhe efektivitetin e feedback-ut që u jepet nxënësve. Studimi synon të identifikojë mospërputhjet metodologjike mes mësuesve të gjeneratave të ndryshme në qasjen ndaj vlerësimit të vazhdueshëm. Metodologjia e aplikuar bazohet në një qasje kuantitative, me një dizajn deskriptiv-analitik dhe korrelacional që lejon identifikimin e lidhjeve shkak-pasojë përmes të dhënave numerike. Hulumtimi u realizua përmes një kampionimi të rastësishëm të thjeshtë, të shtrirë në 18 shkolla filllore të rajonit të Gjilanit, Vitisë dhe Kamenicës (9 urbane dhe 9 rurale), duke përfshirë një mostër reprezentative prej 500 nxënësish dhe 100 mësimitdhënësish. Mostra u stratifikua për të siguruar një përfaqësim të barabartë të variablave demografike. Variabla e pavarur e studimit është vlerësimi formativ, ndërsa variabla e varur është motivimi i nxënësve, duke konsideruar përvojën e punës si variabël moderuese. Për mbledhjen e të dhënave primare u përdorën tri instrumente të standardizuara: pyetësori i (Tuan, H.-L., Chin, C.-C., & Shieh, S.-H., 2005) për motivimin në shkenca, i cili përbëhet nga 22 pyetje me shkallë të Likertit (1-5) dhe (Cronbach's Alpha .976); shkalla e (Nicol, D. J., & Macfarlane-Dick, D, 2006) me 10 pyetje për praktikën e feedback-ut. Procedura e mbledhjes së të dhënave u realizua duke respektuar parimet etike të anonimitetit, konfidencialitetit dhe pëlqimit të informuar. Përpunimi i të dhënave u bë përmes paketës statistikore SPSS (versioni 26.0), duke aplikuar testet e korrelacionit të Pearson-it për të matur forcën e lidhjes mes variablave, si dhe analizën e variancës (One-Way ANOVA) me testet *post-hoc* (Tukey, 1949) për të testuar dallimet bazuar në kategoritë e përvojës. Rezultatet dëshmojnë se përdorimi i rregullt i mjeteve formative rrit ndjeshëm interesimin shkencor, vetë-efikasitetin dhe vetë-rregullimin të nxënësit. Ky punim ofron rekomandime praktike për nevojën e trajnimeve të vazhdueshme profesionale, duke u bazuar në gjetjet e (Palm, T., & Andersson, C., 2017) dhe (Näsström, G., Gardelli, T., Lindberg, O. J., & Pettersson, F., 2021) për transformimin e kulturës së vlerësimit në shkollat filllore.

Fjalët kyçe: *vlerësimi formativ, shkencat natyrore, motivimi i nxënësve, përvoja e punës, arsimit fillor.*

1. HYRJJE

Realizimi i lëndës "Njeriu dhe Natyra" në ciklin fillor është esencial për përmbushjen e kompetencave të përcaktuara në Kornizën Kurrikulare. Përmes gërshetimit të teknikave dhe metodave bashkëkohore me dukuritë natyrore, arrihet një nivel i lartë i mësimitdhënies dhe mësimitnxënies. Kjo qasje cilësore ndikon drejtpërdrejt në konsolidimin e njohurive dhe shkathësisë të nxënësve, duke rezultuar në një performancë dhe produktivitet më të lartë akademik. Mbështetur në përvojën time direkte në procesin edukativ-arsimor, vërehet një nevojë imediate për ndërhyrje profesionale në vlerësimin formativ brenda shkencave natyrore. Duke qenë se këto shkenca kanë rëndësi jetike në formimin e hershëm të fëmijës, qëllimi i këtij punimi është të identifikojë nevojat për ndryshim në metodologjinë e vlerësimit. Synimi final mbetet ofrimi i praktikave të suksesshme dhe rekomandimeve që shërbejnë për reformimin e vlerësimit formativ në dobi të nxënësve.

2. MATERIALE DHE METODA

Si pjesë e punimit tim të doktoratës, në këtë studim janë shtjelluar këto hipoteza: Hipoteza 1, Me rritjen e përdorimit të vlerësimit formativ do të rritet edhe motivimi i nxënësve në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor; Hipoteza 2, Ekzistojnë dallime në eksperiencën e punës në përdorimin e vlerësimit formativ nga mësuesit në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor. Mësuesit me eksperiencë më të vogël të punës e aplikojnë më tepër vlerësimin formativ se sa mësuesit me eksperiencë më të lartë të punës. Në këtë studim kemi aplikuar tri instrumente matëse. Instrumenti i parë ka 22 pyetje me 5 shkallë vlersuese dhe matë motivimin e nxënësve në mësimit për shkencat e natyrës. Ky pyetësor është atandarizuar nga (Tuan, H.-L., Chin, C.-C., & Shieh, S.-H., 2005). Ky pyetësor është i strukturuar për të ofruar një pamje të përgjithshme të motivimit dhe përfshirjes së nxënësve në mësimin e shkencave të natyrës. Instrumenti i dytë ka 10 pyetje me 2 shkallë vlersuese dhe matë vlerësimin formativ tek mësimitdhënësit. Ky pyetësor është hartuar nga (Nicol, D. J., & Macfarlane-Dick, D, 2006). Instrumenti tretë ka 22 pyetje me 5 shkallë vlersuese Ky pyetësor është hartuar nga (Viberg, O., Khalil, M., & Baars, M., 2020) për të vlerësuar përgatitjen e mësuesve për të përdorur teknologjinë digjitale në mësimitdhënie.

Tabela 1: Cronbach's Alpha për instrumentet matëse

	Cronbach's Alpha	N of Items
Trajnimi i mësimdhënësve	.918	4
Vlerësimi formativ	.931	10
Përdorimi i teknologjisë	.964	22
Motivimi i nxënësve	.976	10
Performanca e nxënësve	.987	5

Burimi: Hulumtim i autorit

Për secilin prej këtyre aspekteve të mësimit, rezultatet e Cronbach's Alpha tregojnë një konsistencë të lartë në mes të pyetjeve të përdorura për të matur këto aspekte të ndryshme të përvojës së mësimit. Kjo sugjeron që instrumentet e përdorura janë të besueshme dhe të vlefshme për të matur këto aspekte të mësimit. Mostra e këtij hulumtimi është mostër homogjene. Mostër të këtij hulumtimi janë mësimdhënësit dhe nxënësit. Mostra e hulumtimit përfshin një shtrirje gjeografike në rajonet e **Gjilanit, Kamenicës dhe Vitisë**, duke përfshirë gjithsej 14 institucione shkollore. Në Gjilan, studimi realizohet në gjashtë shkolla të zonave urbane dhe rurale (Bresalc, Gllamë, Ponesh dhe Zhegër. Në Kamenicë dhe Viti, mostra shtrihet në nga katër shkolla për secilin qytet, të ndara në mënyrë të barabartë mes qendrave urbane dhe zonave rurale si Koretini, Topanica, Vërbani dhe Begunca. Thuajse prej secilës shkollë kemi marrë për mosër prej 50 nxënës, gjithësej 500 nxënës si dhe 100 mësimdhënës. Mostra është airtë në mënyrë të rastësishme. Të dhënat kryesore, si përqindjet, shuma, minimumi dhe maksimumi janë llogaritur përmes procedurave standarde të metodës statistikore. Tabelat dhe grafikët paraqiten në bazë të përpunimit të të dhënave në mënyre elektronike me ndihmën e programit SPSS. Për të paraqitur një pamje të përgjithshme të të dhënave të grumbulluara, u aplikua analiza deskriptive. Kjo përfshin statistika bazike, si përqindjet, mesataren, dhe devijimin standard për të organizuar dhe përmbledhur të dhënat sipas moshës, gjinisë, vendodhjes së shkollës, etj. Për testimin e hipotezës H3, u përdoren analizat korrelacionale për të vlerësuar lidhjen e ndërsjellë midis variablave të ndryshme. Hipoteza H2 u testua përmes analizës së Anova. Kjo analizë na ka ndihmuar të vlerësojmë se nëse ka dallime në përdorimin e vlerësimit formativ nga mësuesit në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor lidhur me faktorë si moshja, përvoja e punës, dhe vendodhja e shkollës.

3. REZULTATE

Hipoteza 1: Me rritjen e përdorimit të vlerësimit formativ do të rritet edhe motivimi i nxënësve në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor.

Tabela 2: Ndërlidhja në mes vlerësimit formativ dhe motivimit të nxënësve

		Motivimi i Vlerësimi formative nxënësve	
Vlerësimi formative	Koeficienti i korrelacionit	1.000	.541**
	Sig. (2-anët)		.000
	N	100	100
Motivimi i nxënësve	Koeficienti i korrelacionit	.541**	1.000
	Sig. (2-anët)	.000	
	N	100	100

Burimi: Hulumtim i autorit

Tabela 2, paraqet rezultatet e analizës së ndërlidhjes midis vlerësimit formativ dhe motivimit të nxënësve në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor. Në tabelë, koeficienti i korrelacionit midis këtyre dy variablave është .541, dhe është shënuar me **, tregon një korrelacion pozitiv dhe të rëndësishëm statistikiht (Sig. = .000). Kjo

tregon se ka një lidhje pozitive dhe të rëndësishme statistikisht midis përdorimit të vlerësimit formativ dhe motivimit të nxënësve në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor. Në këtë kontekst, rezultatet sugjerojnë se sa më shumë përdorohet vlerësimi formativ, aq më i lartë është motivimi i nxënësve. Bazuar në këto rezultate, hipoteza 1, është vërtetuar; me rritjen e përdorimit të vlerësimit formativ, rritet edhe motivimi i nxënësve në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor.

Hipoteza 2: Ekzistojnë dallime në eksperiencën e punës në përdorimin e vlerësimit formativ nga mësuesit në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor. Mësuesit me eksperiencë më të vogël të punës e aplikojnë më tepër mësimin formativ se sa mësuesit me eksperiencë më të lartë të punës.

Tabela 3: Të dhënat deskriptive për dallimet në eksperiencën e punës në përdorimin e vlerësimit formativ nga mësuesit në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor

	N	Mesatarja	Devijimi Std
Bachelor	71	2.6690	.87093
Master	14	3.8214	.11720
PhD	15	4.3833	.28137

Burimi: Hulumtim i autorit

Tabela 3, përmban të dhënat deskriptive për dallimet në eksperiencën e punës në përdorimin e vlerësimit formativ nga mësuesit në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor. Në bazë të këtyre të dhënave, mesatarja e përdorimit të vlerësimit formativ për grupet e eksperiencës së punës është si vijon: për mësuesit me gradë Bachelor mesatarja është 2.66, për ata me Master mesatarja është 3.82, dhe për ata me PhD mesatarja është 4.38. Këto të dhëna sugjerojnë një rritje të përdorimit të vlerësimit formativ me rritjen e nivelit të eksperiencës së punës të mësuesve.

Tabela 4: Analiza ANOVA për dallimet në eksperiencën e punës në përdorimin e vlerësimit formativ nga mësuesit në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor

	Shuma e katrorëve	df	Mesatarja n'kator	F	Sig.
Ndërmjet grupeve	45.163	2	22.582	40.277	.000
Brenda grupeve grupeve	54.384	97	.561		
Total	99.547	99			

Burimi: Hulumtim i autorit

Tabela 4, përmban analizën ANOVA për dallimet në eksperiencën e punës në përdorimin e vlerësimit formativ nga mësuesit në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor. Rezultatet tregojnë një dallim të rëndësishëm statistikor midis mesatareve të përdorimit të vlerësimit formativ për grupet e eksperiencës së punës ($F = 40.27$, $df = 2$, $Sig. = .00$). Kjo tregon se ka një ndryshim statistikisht të rëndësishëm midis grupmoshave të eksperiencës së punës në përdorimin e vlerësimit formativ nga mësuesit. Bazuar në këto rezultate, hipoteza 2 është vërtetuar; Ka dallime në eksperiencën e punës në përdorimin e vlerësimit formativ nga mësuesit në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor, ku mësuesit me eksperiencë më të vogël të punës aplikojnë më tepër mësimin formativ se sa ata me eksperiencë më të lartë të punës.

4. DISKUTIME

Diskutime për Hipotezën 1: Me rritjen e përdorimit të vlerësimit formativ do të rritet edhe motivimi i nxënësve në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor. Analiza e ndërlidhjes midis përdorimit të vlerësimit formativ dhe motivimit të nxënësve në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor jep një panoramë të rëndësishme për efektin e praktikave të mësimdhënies në stimulimin e motivimit të nxënësve. Kjo gjetje është e rëndësishme për praktikën arsimore, pasi sugjeron që mësuesit që përdorin më shumë vlerësimin formativ kanë tendencë të krijojnë një mjedis më të përkrahur dhe më të motivuar për nxënësit e tyre. Duke ofruar feedback të vazhdueshëm dhe ndihmë për përmirësimin e performancës së nxënësve, vlerësimi formativ ndihmon në rritjen e ndjenjës së vetëbesimit dhe motivimit të nxënësve për të përfshirë dhe përparuar në mësimin e shkencave të natyrës. Duke u përqendruar në zhvillimin e kapaciteteve për të përdorur më efektivisht praktikën e vlerësimit formativ, mësuesit mund të krijojnë një mjedis më stimulues dhe mbështetës për nxënësit, duke i nxitur ata të angazhohen dhe të

përparojnë në mësimin e shkencave të natyrës. Në të njëjtën kohë, ky rezultat mund të shërbejë si bazë për hulumtime të mëtejshme dhe për zhvillimin e strategjive më të avancuara për të përmbushur objektivat e motivimit të nxënësve në lëndën e shkencave të natyrës. Duke identifikuar dhe përdorur metodat më efektive për të përmirësuar motivimin e nxënësve, mund të ndikohet në një rritje të qëndrueshme të performancës së nxënësve dhe në arritjen e sukseseve të tyre të mësimin. Këto gjetje i krahasuam edhe me gjetjet e studimit të (Näsström, G., Gardelli, T., Lindberg, O. J., & Pettersson, F., 2021), ata hulumtuam ndryshimet në motivimin e studentëve kur mësuesi zbatonte praktikën e vlerësimit formativ. U identifikuan disa lloje vendimesh, dhe dijen dhe aftësitë e nevojshme për t'i marrë ato, që kapin ato të nevojshme në praktikatat më tradicionale të mësimin. Studentët në klasën e mësuesit në ndërhyrje rritën format e tyre të motivimit të kontrolluar dhe autonome si dhe përfshirjen e tyre në aktivitetet e mësimin më shumë se studentët në klasat krahasuese.

Diskutime për Hipotezën 7: *Ekzistojnë dallime në eksperiencën e punës në përdorimin e vlerësimit formativ nga mësuesit në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor. Mësuesit me eksperiencë më të vogël të punës e aplikojnë më tepër mësimin formativ se sa mësuesit me eksperiencë më të lartë të punës.* Analiza e dallimeve në eksperiencën e punës në përdorimin e vlerësimit formativ nga mësuesit në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor ofron një perspektivë interesante rreth ndikimit të përvojës në praktikatat e mësimdhënies. Tabela 3, jep një përshkrim të mesatareve të përdorimit të vlerësimit formativ për grupet e eksperiencës së punës, duke treguar një rritje të përdorimit të vlerësimit formativ me rritjen e nivelit të eksperiencës së punës të mësuesve. Tabela 4, paraqet analizën ANOVA për dallimet në eksperiencën e punës në përdorimin e vlerësimit formativ nga mësuesit. Rezultatet e kësaj analize konfirmojnë se ka një ndryshim statistikisht të rëndësishëm në mes të grupmohave të eksperiencës së punës në përdorimin e vlerësimit formativ nga mësuesit në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor.

Bazuar në këto rezultate, hipoteza 2, është vërtetuar; ka dallime në eksperiencën e punës në përdorimin e vlerësimit formativ nga mësuesit në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor, me mësuesit me eksperiencë më të vogël të punës që aplikojnë më tepër mësimin formativ se sa ata me eksperiencë më të lartë të punës. Kjo gjetje mund të shpjegohet nga faktorë si përshtatshmëria e metodave mësimore dhe ndërjegjësimi i nevojës për të ndryshuar praktikatat e mësimdhënies në bazë të përvojës së punës. Në gjetjet e një projekti kërkimor dyvjeçar në Zelandën e Re i realizuar nga (Bell, B., & Cowie, B., 2001) tregojnë se vlerësimi formativ ka karakteristikat e mëposhtme: përgjigjshmëria, burimet e provave, një proces i pashprehur, përdorimi i njohurive dhe eksperiencave profesionale, pjesë e pandarë e mësimin dhe nxënies,

5. KONKLUZIONE

Pas shqyrtimit të gjerë të të dhënave dhe analizës së rezultateve të studimit mbi zbatimin e vlerësimit formativ në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor, dalim me disa përfundime kyçe që sjellin dritë mbi rëndësinë dhe përfitimet e këtij procesi në kontekstin arsimor. Vlerësimi formativ është ndër faktorët kyç për performancën e nxënësve, motivimin e tyre, dhe për përdorimin e teknologjisë në procesin e mësimin. Këto përfundime thellojnë kuptimin tonë për rëndësinë dhe impaktin e vlerësimit formativ në arsimin fillor, duke dhënë një bazë të qëndrueshme për përmirësimin e praktikave arsimore dhe për kërkime të mëtejshme në këtë fushë. Hipoteza e parë konfirmohet nga rezultatet e analizës së ndërlidhjes midis vlerësimit formativ dhe motivimit të nxënësve. Një korrelacion pozitiv dhe të rëndësishëm statistikor tregon se sa më shumë përdorohet vlerësimi formativ, aq më i lartë është motivimi i nxënësve në mësimin e shkencave të natyrës në arsimin fillor. Hipoteza e dytë konfirmohet nga rezultatet e analizës së dallimeve në eksperiencë të punës, ku mësuesit me eksperiencë më të vogël të punës aplikojnë më tepër mësimin formativ se ata me eksperiencë më të lartë të punës.

FALENDERIME

Ky punim u realizua me mbështetjen dhe bashkëpunimin e shumë individëve dhe institucioneve. Një mirënjohje e veçantë u shkon drejtorive arsimore dhe shkollave fillore në Gjilan, Viti dhe Kamenicë, si dhe mësuesve e nxënësve që u bënë pjesë e këtij kërkimi. Falënderoj mentoren për udhëzimet e vlefshme shkencore dhe stafin që ndihmoi në redaktimin gjuhësor dhe teknik të dorëshkrimit, duke kontribuar në cilësinë përfundimtare të këtij studimi.

REFERENCAT

- Airasian, P. (1994). *Classroom assessment* [Vlerësimi në klasë]. McGraw-Hill.
- Anderson, C., & Palm, T. (2017). *The impact of formative assessment on student achievement: A study of the effects of changes to classroom practice after a comprehensive professional development programme* [Ndikimi i vlerësimit formativ në arritjet e nxënësve: Një studim mbi efektet e ndryshimeve në praktikën e klasës pas një programi gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional]. Knowledge Centre for Education.
- Nurhayati, A. (2020). The implementation of formative assessment in EFL writing: A case study at a secondary school in Indonesia [Zbatimi i vlerësimit formativ në shkrimin e gjuhës angleze si gjuhë e huaj: Një studim

- rasti në një shkollë të mesme në Indonezi]. *Pedagogy: Journal of English Language Teaching*, 8(1), 12-25. <https://doi.org/10.32332/pedagogy.v8i1.1818>
- Black, P., & Wiliam, D. (1998). Inside the black box: Raising standards through classroom assessment [Brenda kutisë së zezë: Ngritja e standardeve përmes vlerësimit në klasë]. *Phi Delta Kappan*, 80(2), 139-144. (Ky është studimi më i cituar në botë për vlerësimin formativ).
- Black, P., & Wiliam, D. (2009). Developing the theory of formative assessment [Zhvillimi i teorisë së vlerësimit formativ]. *Educational Assessment, Evaluation and Accountability*, 21(1), 5-31. <https://doi.org/10.1007/s11092-008-9068-5>
- Heritage, M. (2007). Formative assessment: What do teachers need to know and do? [Vlerësimi formativ: Çfarë duhet të dinë dhe të bëjnë mësuesit?]. *Phi Delta Kappan*, 89(2), 140-145. <https://doi.org/10.1177/003172170708900210>
- Ruiz-Primo, M. A., & Furtak, E. M. (2007). Exploring teachers' informal formative assessment practices and students' understanding in the context of scientific inquiry [Eksplorimi i praktikave joformale të vlerësimit formativ të mësuesve dhe kuptimi i nxënësve në kontekstin e kërkimit shkencor]. *Journal of Research in Science Teaching*, 44(1), 57-84. <https://doi.org/10.1002/tea.20163> (Specifike për Shkencat e Natyrës).
- Sadler, D. R. (1989). Formative assessment and the design of instructional systems [Vlerësimi formativ dhe dizajni i sistemeve udhëzuese]. *Instructional Science*, 18(2), 119-144.
- Shavelson, R. J., Young, D. B., Ayala, C. C., Brandon, P. R., Furtak, E. M., Ruiz-Primo, M. A., Tomita, M. K., & Yin, Y. (2008). On the impact of curriculum-embedded formative assessment on learning: A case study in Hawaii [Mbi ndikimin e vlerësimit formativ të integruar në kurrikulë në të nxënit: Një studim rasti në Havai]. *Applied Measurement in Education*, 21(4), 295-314.
- Hockett, J. A., & Doubet, K. J. (2022). *Formative assessment in the secondary science classroom: Tools and strategies for internalizing learning goals*. ASCD.
- Li, H., & Lajoie, S. P. (2021). Cognitive and affective processes in digital formative assessment: A systematic review. *Educational Psychology Review*, 33(2), 523–551. <https://doi.org/10.1007/s10648-020-09553-w>
- Nieminen, J. H., & Tuohilampi, L. (2022). ‘Finally I’m beginning to learn’: A case study of formative assessment and student motivation in mathematics and science. *International Journal of Science and Mathematics Education*, 20(4), 793–815. <https://doi.org/10.1007/s10763-021-10174-z>
- Wiliam, D. (2021). *Embedded formative assessment* (2nd ed.). Solution Tree Press. (Ky mbetet një autoritet kyç për vlerësimin formativ, me botime të përditësuara).
- Yan, Z., & Pastore, S. (2022). *Formative assessment in higher education and primary schools: International perspectives on theory and practice*. Routledge.